VENDIM
Nr. 152, datë 28.9.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 28.9.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e "Draftlicencës për veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike", të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 37 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", ERE lëshon licencë për veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike.
- Neni 37, pika 3, parashikon që ERE vendos kushtet e licencës për veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e licencës për veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti